



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201600024/3

Tiranë ____/____/2016

Lënda : *Rekomandojmë marrjen e masave për shpejtimin e gjykimit të çështjes administrative me Nr.9730 akti, datë 19.11.2014, me ankues F. L. nga Tirana.*

Drejtuar : Z. KASTRIOT SELITA
Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit
TIRANË

I nderuar zoti Kryetar,

Në ankesën e tij drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi F. L. nga Tirana, ankohet për zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore dhe shkeljen e procedurave gjyqësore nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në gjykimin e një çështje gjyqësore administrative.

Nga ankesa e tij rezulton se kjo dosje gjyqësore tani ndodhet e regjistruar për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, me Nr.9730 akti datë 19.11.2014, dhe si Relatore e saj është caktuar Zj.Lindita Sinanaj e cila nuk është planifikuar akoma për gjykim e çështjes Ankuesi F. L. nga ana e tij ka kërkuar ndihmë dhe ndërhyrjen e institucionit tonë për shpejtimin e këtij gjykimi sa më shpejt në të ardhmen, dhe në mbrojtje të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor nga ana jonë u çmua e arsyeshme të ndërhyhet me rekomandim.

Duke analizuar ankesën e tij dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të RSH në bazë të kërkesave të nenit 63/3 të Kushtetutës ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut, nga administrata publike. Në dispozitat ligjore të nenit 49/2 të Ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", thuhet se, Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve, nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi.

Në rastin konkret rezulton se dosja ndodhet e regjistruar me datë 19.11.2014 dhe akoma nuk është caktuar data dhe ora e gjykimit të saj. Ky veprim është konsideruar shkelje e një procesi të rregullt gjyqësor edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila me vendimin e saj Nr.81 datë 28.12.2015 ka vendosur pranimin e kërkesës. Kështu në bazë të këtij vendimi thuhet se në

nenin 3 të Ligjit nr.49/2012 përcaktohet sigurimim i një procesi të rregullt ligjor brenda afateve të shpejta e të arsyeshme.

Ligji në rastin konkret synon në thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrveshjeve administrative dhe se vet qëllimi i krijimit të gjykatave administrative është garantimi i mbrojtjes efektive të të drejtave të subjektit dhe interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor dhe brenda afateve sa më të shpejta e të arsyeshme.

Në këto kushte dhe bazuar në kërkesat e nenit 21/b të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999" Për Avokatin e Popullit", ku thuhet se pas përfundimit të hetimit, Avokati i P paraqet rekoamndim për vënien në bvend të së drejtës së shkelur tek organi administrative që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive

Pë sa sipër, Ju

REKOMANDOJMË :

1.Marrjen e masave organizative për shpejtimin e gjykimit të çështjes administrative me Nr.9730 akti, datë 19.11.2014 me ankues F.L. nga Tirana.

2.Mbi anazën dhe masat e marra në zbatim të këtij rekomandimi nga ana juaj, lutemi të njoftomi me shkrim brenda një afati prej 30 ditësh.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI